



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të nenit 51, paragrafi 51.1, të nenit 53, paragrafi 53.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershore 2008), të neneve 8, 9 dhe 10 të Udhëzimi administrativ, nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d, të nenit 44, paragrafi 44.1, pika b dhe nenit 46 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, të nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110 - 273423, të dt. 09.12.2014, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

I.

Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për komunitete, si komitet i përhershëm.

II.

Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

- 1. Valbona Petrovci, përfaqësuese e shumicës;**
- 2. Elmire Nikçi - Rexha, përfaqësuese e shumicës;**
- 3. Hetem Kupina, përfaqësues i shumicës;**
- 4. Nenad Miladinović, përfaqësues i komunitetit serb;**
- 5. Oktaj Kurtesh, përfaqësues i komunitetit turk;**
- 6. Mirsada Behluli, përfaqësuese e komunitetit boshnjak;**
- 7. Idriz Berisha, përfaqësues i komunitetit ashkali;**
- 8. Adnan Ajeti, përfaqësues i komunitetit rom dhe**
- 9. Kimete Shok, përfaqësuese e komunitetit goran.**

III.

Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për promovimin dhe afirmimin e të drejtave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, bën rekomandime në Kuvendin e Komunës, shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës, si dhe ushtron edhe

përgjegjësi të tjera, nëse nuk është rregulluar ndryshe me LVL-në dhe me Statutin e Komunës.


IV.

Anëtarëve të cekur në pikën II të këtij vendimi, do t'u takojë kompensimi për punën e tyre në pajtim me Udhëzimin administrativë nr. 08/2008, për pagesën e stafit politik në komuna.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-57676/18, më 09.03.2018



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës, në pajtim me dispozitat e nenit 51, paragrafi 51.1 i LVL-së, është i obliguar të formojë Komitetin për komunitete, si komitet i përhershëm.

Sipas Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110- 273423, të dt. 09.12.2014, Komiteti për komunitete nga nëntë (9) anëtarë që duhet të ketë në përbërje:

- një (1) nga komuniteti rom, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- një (1) nga komuniteti turk, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- një (1) nga komuniteti ashkali, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- një (1) nga komuniteti boshnjak, i cili është përfaqësues i komunitetit, por jo anëtar i Kuvendit të Komunës;
- dy (2) nga komuniteti serb, njëri duhet të jetë anëtar i Kuvendit;
- tre (3) nga përfaqësuesit e shumicës, shqiptarë, së paku njëri prej tyre duhet të mos jetë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

Për të theksuarën, ky propozimvendim për formimin e Komitetit për komunitete i dërgohet në kompetencë të mëtejme Komitetit për Politike dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.